




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr Prot. Br Prot. Prot No
DPKI	06-477/20
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
02	25-02-2020
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nëparag. 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nëparag. 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 21.02.2020, mori:

**V E N D I M**

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPKI-06-2853/19*, për zyrtarin e lartë publik z. Sami Salihu, Anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.**
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë publik z. Salihu, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi që është identifikuar se zyrtari i lartë publik z. Salihu, Anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, njëkohësisht është edhe person i autorizuar në biznesin privat: “Power Fruits” SH.P.K.

Agjencia kundër Korrupsionit (në vijim: Agjencia), me qëllim të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesit ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), sigurimin e informatave për biznesin në fjalë. Nga informatat për biznesin të dërguara prej ARBK-së (DPKI-06-2388-1/19), është konstatuar se zyrtari i lartë z. Salihu, është person i autorizuar në biznesin e sipërshënuar.





Agjencia, me shkresën zyrtare DPKI-06-150/20, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar një takim me zyrtarin e lartë në zyrat e Agjencisë, me ç'rast z. Salihu është njoftuar me faktet që posedon Agjencia.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë person i autorizuar në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku përcaktohet se:

*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”.*

Zyrtari i lartë z. Salihu, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë, por ka deklaruar se nuk e ka ditur që kjo është në kundërshtim me ligjin. Ai ka premtuar se do të ndër marrë veprime në mënyrë që ta shmangë gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën (DPKI-06-418/20) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë ka bërë ndryshimet e nevojshme në biznes.

Pas analizimit të informatës mbi biznesin, Agjencia konstatoi se zyrtari i lartë z. Salihu, ka transferuar të drejtat e drejtimit të bizneshit privat tek personi i besuar, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënpar. 1.1 lidhur me nenin 15 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndër marrë zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

